

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ligji i ri amerikan kundër Rusisë, Trump mund të ndëshkojë vendet që blejnë naftë dhe gaz nga Moska
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/ligji-i-ri-amerikan-kunder-rusise-trump-mund-te-ndeshkoj-e-vendet-qe-blejne--i586997
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 06:25:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 06:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4d0ee4fea80c22c97d8c2937ced7a0a9ea1ca09531734b52487fe581305b7eb4
TEKSTI	83e6a9b9f681c15873b65cb68bb141e7b98e2dc8448fd132319ebffc0b33a24e
PAMJA	bf96d6aeb7f775ff4e0b739683db121b53a185919f186aea782d616078762748

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1eb4af52c37232caadcb3ea9e6e68fb2d8bb1264f74b6ecab5a5628444b111bc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1eb4af52c37232caadcb3ea9e6e68fb2d8bb1264f74b6ecab5a5628444b111bc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by  [Kontakt](#)



 [English](#)



le [Marreveshje historike per Groenlanden, SHBA zgjeron pranine ushtarake pa ndryshuar sovranitetin danez](#) "The Independent" rekomandon Shqiperine: Pushime mes Rr fundit

Ligji i ri amerikan kundër Rosisë, Trump mund të ndëshkojë vendet që blejnë naftë dhe gaz nga Moska



19 Shtator 2026, 08:45Bota TEMA



Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka firmosur ligjin e ri që forcon sanksionet ndaj Rosisë dhe Iranit dhe i jep administratës amerikane kompetenca të reja për të ushtruar presion ekonomik ndaj Moskës.

Ligji, i emërtuar "Lindsey O. Graham Sanctioning Russia and Iran Act of 2026", parashikon masa ndaj zyrtarëve rusë, oligarkëve, bankave dhe institucioneve financiare të lidhura me Rusinë.

Një nga pikat kryesore të ligjit është mundësia që presidenti amerikan të vendosë tarifa deri në 100% ndaj vendeve që blejnë naftë dhe gaz natyror rus. Masat nuk vendosen automatikisht, por ligji i jep presidentit autoritetin për t'i zbatuar ato.

Kjo dispozitë mund të prekë veçanërisht Kinën dhe Indinë, dy prej blerësve kryesorë të naftës ruse. Uashingtoni synon përmes këtyre masave të rrisë presionin ekonomik ndaj Moskës dhe të kufizojë të ardhurat e saj nga eksportet energjetike.

Ligji parashikon gjithashtu sanksione ndaj sektorëve energjetikë dhe të mbrojtjes së Rosisë, si dhe ndaj individëve dhe kompanive që mbështesin aktivitetet e saj.

Përveç Rosisë, paketa e re zgjeron edhe sanksionet ndaj Iranit, duke përfshirë sektorët energjetikë dhe të armëve

Projektligji ishte miratuar më herët nga Senati dhe më pas nga Dhoma e Përfaqësuesve, me mbështetje nga ligjvënës të të dyja partive.

Ligji mban emrin e senatorit republikan Lindsey Graham, një prej mbështetësve të fortë të Ukrainës, i cili ndërroi jetë në korrik.

Firmosja e ligjit nga Trump shënon një tjetër hap të Shteteve të Bashkuara në përpjekjet për të rritur presionin ekonomik ndaj Rosisë, ndërsa vendimi për vendosjen e tarifave ndaj vendeve që blejnë energji ruse mbetet në kompetencën e presidentit amerikan.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Trump përjashton CNN, Politico dhe MsNow nga Shtëpia e Bardhë: Përhapin lajme të rreme!](#)

08:05 Bota

Raporti i rremë i IA-së për pak sa nuk nisi luftë mes SHBA-së dhe Kinës, CNN: Operacioni u anulua në momentin e fundit

07:56 Bota

Zgjedhjet e së dielës në Berlin dhe Mecklenburg! Një provë e re për Merzin pas humbjes së rëndë në Saksoni

07:43 Bota

[IA merr në dorë propagandën/ NYT: Si Kina, Irani dhe kompani izraelite po manipulojnë debatin online përmes profileve të rreme](#)

22:50 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.